



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PARLAMENTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Datë 20.02.2019

Dokument Parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR CENSIN E POPULLSISË DHE TË BANESAVE”

- ***Hyrje***

Komisioni për Integrimin European (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë **20.02.2019**, me cilësinë e Komisionit **për dhënie mendimi**, mori në shqyrtim projektligjin “***Për censin e popullsisë dhe të banesave***”.

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje ishte pranishëm INSTAT e përfaqësuar nga Znj. Delina Ibrahimja, Drejtoreshw e Pwrgjithshme

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Ky projektligj është nismë e Këshillit të Ministrave i propozuar nga Zëvendëskryeministri në mbështetje të neneve 81 pika 1 i Kushtetutës si dhe neni 68 i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë neni 81 dhe Rregullores së Kuvendit, neni 55 pika 1 ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Sipas relacionit, qëllimi i projektligjit është krijimi i bazës ligjore të konsoliduar për kryerjen e censit të popullsisë dhe banesave, duke marrë në konsideratë standardet e reja ndërkombëtare të vendosura për censet e ardhshme të popullsisë dhe banesave, terminologjinë, procedurat dhe institucionet e përfshira. Projektligji hartohet bazuar në nenin 3, të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”, sipas të cilit realizimi i censit rregullohet me ligj të veçantë.

Objektivat që synohen të arrihen:

1. Prodhimi i statistikave të popullsisë dhe banesave, duke mirëpërcaktuar me ligj:
 - a) rolin e INSTAT-it, si institucioni përgjegjës për kryerjen e suksesshme të procesit;
 - b) rolin mbështetës, që luajnë institucionet e ekzekutivit dhe ato të vetëqeverisjes vendore;

c) rregullimin e proceseve të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të të dhënave si dhe administrimin e informacionit të mbledhur;

ç) detyrimet e subjekteve për të dhënë informacionin e kërkuar, nëpërmjet pyetësorëve të censit;

d) prodhimin e statistikave zyrtare të popullsisë dhe banesave në mënyrë profesionale, shkencore dhe të besueshme.

2. Kryerja e censit të popullsisë dhe banesave në përputhje me rekomandimet dhe standardet e reja ndërkombëtare:

a) duke përcaktuar terminologjitë statistikore në linjë me ato të përdorura nga Eurostat;

b) duke përmblusur rekomandimet e institucioneve kompetente kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me zhvillimin e censit të ardhshëm.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis të BE-së***

Plani Kombëtar për Integrimin European 2017-2020

Ky projektligj është në përputhje me objektivat strategjikë dhe prioritetet e parashikuara në **Kapitullin 18** “Statistikat” të Planit Kombëtar për Integrimin European (**PKIE**) **2018-2020**. Në planin Kombëtar është parashikur që të ketë shtesa dhe ndryshime në legjislacionin ekzistues, por duke marrë parasysh nevojën për ndryshime të medha, është propozuar një projektligj integral.

1. ASPEKTET PROCEDURIALE TË PËRAFRIMIT

- Neni 70 i MSA-së njeh rëndësinë dhe parashikon detyrimin e përafrimit të legjislacionit Shqiptar me atë të Bashkimit European;
- Neni 17, pika 2 e ligjit Nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”, përcakton se projektligjet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave shoqërohen me tabelën që analizon shkallën e përputhshmërisë me të drejtën e Bashkimit European;
- Neni 68, pika 2 e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë parashikon që Projektligjet duhet të shoqërohen me një relacion shpjegues, i cili përmban vlerësimin e harmonizimit të projektligjit me legjislacionin e BE-së.

2. ASPEKTET MATERIALE TË PËRAFRIMIT

Acquis e BE-së që përafrohet nga Projektligji i propozuar:

Legjislacioni parësor i BE-së:

- Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit European (TFBE): **Neni 338**, (ish-neni 285 TKE),
- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE- Shqipëri (MSA): Titulli VIII “Politikat e Bashkëpunimit”, **Neni 88 “Bashkëpunimi Statistikor”**.

Legjislacioni dytësor i BE-së:

- **Rregullorja (KE) Nr. 763/2008 e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 9 Korrik 2008 “Mbi censet e popullsisë dhe të banesave”**.
- **Rregullorja Zbatuese (BE) Nr. 2017/543 e Komisionit, datë 22 Mars 2017 “Për caktimin e rregullave për zbatimin e Rregullores (KE) Nr. 763/2008 të Parlamentit European dhe të Këshillit “Mbi censet e popullsisë dhe të banesave” përsa i takon specifikimeve teknike të temave dhe nënndarjeve të tyre”**.

Niveli i Përafrimit: I pjesëshëm.

- Shkalla e përafrimit të projektligjit të paraqitur me Acquis të BE-së është e pjesshme. Pra, projektligji në fjalë është në përputhje (nuk bie në kundërshtim) me dispozitat e burimeve parësore dhe dytësore të Acquis të BE-së të lartpërmendura, por nuk është në përputhje me të gjitha parimet që rrjedhin prej këtyre dispozitave.

- ***Konsultimi publik (nëse i është nënshtruar këtij procesi)***

Nuk ka patur konsultim publik në Komision për Integrimin European

- ***Efektet financiare të aktit (nëse ka)***

Bazuar në relacionin e Projektligjit, duke u bazuar në aktivitetet në tërësi që nevojiten për kryerjen e censit si dhe duke marrë në konsideratë zërat që kanë ofruar donatorët e ndryshëm, është përlogaritur që nga buxheti i shtetit nevojitet një vlerë prej 8 300 000 eurosh e barazvlefshme me **1 116 000 000** lekësh, e shpërndarë në vitet 2019 dhe 2020.

- ***Diskutimi në komision***

Gjatë diskutimeve në Komisionin për Integrimin European u parashtua edhe çështja e mungesës së paraqitjes së plotësisht të rekomandimeve të Agjendës 2030 për zhvillimin e qëndrueshëm. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar një rezolutë në lidhje sa më sipër dhe i është drejtuar qeverisë shqiptare për paraqitjen në relacionin shoqërues të projektgjatit përmbushjen e detyrimeve të vendosura në Agjendën 2030 dhe në rezolutën e Kuvendit.

- ***Ndryshime të projektaktit (nen për nen)***

3. SHQYRTIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË DISPOZITAVE TË PROJEKTLIGJIT ME ACQUIS TË BE

Nga shqyrtimi i përputhshmërisë së projektligjit të propozuar me *acquis* të BE-së rezulton se për një përafrim më të saktë me legjislacionin dytësor të lartpërmendur është e nevojshme që në tekstin e tij të bëhen disa shtesa dhe ndryshime si vijon:

1. Të shtohet shënimi në fund të faqes që lidhet me titullin e projektligjit si më poshtë vijon:

“Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

- Rregulloren (KE) Nr. 763/2008 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 9 Korrik 2008 *“Mbi censet e popullsisë dhe të banesave”*, Numri CELEX 32008R0763, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 218, datë 13.08.2008, faqe 14-20,
- Rregulloren Zbatuese (BE) Nr. 2017/543 të Komisionit, datë 22 Mars 2017 *“Për caktimin e rregullave për zbatimin e Rregullores (KE) Nr. 763/2008” të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, “Mbi censet e popullsisë dhe të banesave” përsa i takon specifikimeve teknike të temave dhe nënndarjeve të tyre”*, Numri CELEX 32017R0543, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 78, 23.03.2017, faqe 13-58”.

2. Shkronja “a” e nenit 3 të projektligjit që jep përkufizimin e termiit “popullsi” të riformulohet si vijon:

“a) **“Popullsi”**, popullsia në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor, e cila gjendet në vendbanimin e zakonshëm në **ditën** e censit;”

3. Shkronja “b” e nenit 3 të projektligjit që jep përkufizimin e termiit “ndërtesë” të riformulohet si vijon:

“b) **“Ndërtesë”**, një ndërtesë e përhershme, që përmban **banesa** të projektuara për banim njerëzor ose **banesa të zakonshme** që janë të rezervuara për banim sezonal, dytësor apo që janë boshe;”

4. Shkronja “ç” e nenit 3 të projektligjit që jep përkufizimin e termiit “Vendbanim i zakonshëm” të riformulohet si vijon:

“ç) **“Vendbanim i zakonshëm”**, vendi ku personi, zakonisht, kalon periudhën e përditshme të pushimit, pavarësisht nga mungesa të përkohshme për qëllime rekreative, pushime, vizita në miq dhe të afërm, biznes, trajtim mjekësor ose pelegrinazhi fetar.

Personat, që konsiderohen si vendbanues të zakonshëm të një zone gjeografike, janë ata:

- i. që kanë jetuar në vendbanimin e tyre të zakonshëm për një periudhë të vazhdueshme, të paktën 12 muaj përpara **ditës së censit**;
- ii. që kanë ardhur në vendbanimin e tyre të zakonshëm gjatë 12 muajve para **ditës së censit**, me qëllim që të qëndrojnë aty për, të paktën, një vit.

Kur rrethanat e përshkruara në paragrafët “i” ose “ii” nuk mundën të përcaktohen, ‘vendbanimi i zakonshëm’ do të thotë vendi i ligjshëm ose vendbanimi i regjistruar. ”

• **Rekomandime**

Të dërgohet në Komisioni për Integrimin Europian pjesa e munguar në lidhje me Agjendën 2030 dhe të përfshihet në relacionet e projektligjeve sipas Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë.

- ***Përfundim***

- Komisioni për Integrimin Europian:
- pasi vlerësoi qëllimin e projekligjit, procedurat ligjore sipas detyrimeve kushtetuese dhe të Rregullores së Kuvendit;
- pasi vlerësoi përputhshmerinë e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian si detyrim i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, neni 70;
- pasi propozoi ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e dispozitave dhe
- pasi konsideroi se projektligji votohet me mazhorancë të thjeshtë,

e votoi aktin ligjor të propozuar nga Këshilli i Ministrave në parim, nen për nen dhe me ndryshime në tërësi dhe me shumicë votash **e miratoi** atë dhe vendosi për vijimin e procedurës sipas Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

NËNKRYETARE

SENIDA MESI